



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr.124, datë 24.12.2020

MBI

MIRATIMIN E KALENDARIT TË PËRGATITJES SË PROGRAMIT BUXHETOR
AFATMESËM (PBA) PËR VITET 2022-2024 DHE BUXHETIT VJETOR

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, ligjit nr.68/2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimit Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr.7/2, datë 09.07.2018 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm për vitet 2019-2021”, Udhëzimit Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm” dhe sipas Relacionit të përgatitur nga Sektori i Analizës së Statistikave dhe Planifikimit Afatmesëm në Drejtorinë e Turizimit, Politikave të Zhvillimit dhe Integritimit Evropian, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e Kalendarit të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) për vitet 2022-2024 dhe Buxhetit Vjetor si më poshtë:

Aktivitetet për hartimin e PBA-së	Afatet
Paraqet për shqyrtim dhe miratim në KB, raportin për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave në bazë të udhëzimeve përkatëse të Ministrisë së	Deri me 31 Janar

Financave për: -dy vitet para vitit buxhetor (2019 dhe 2020) -vitin buxhetor 2021 -tre vitet e ardhshme buxhetore (2022-2024)	
Miraton në KB, raportin për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave.	Deri me 1 Mars
Përgatit dhe paraqet në K.B, tavanet përgatitore të shpenzimeve të PBA-së në nivel programi.	Mars
Miraton në KB, tavanet përgatitore të shpenzimeve të PBA-së në nivel programi.	Brenda 15 Marsit
Miraton udhëzimin e përgatitjes së buxhetit të Nj.Q.V dhe shpërndan tek të gjitha njësitë shpenzuese, pas miratimit të taveve përgatitore të shpenzimeve.	Deri në 20 Mars
Dërgon projekt dokumentin e PBA-së, në M.F. (dy formularët Nr1. dhe Nr.2 për parashikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve).	Deri në 1 Qershor
M.F. analizon dhe dërgon zyrtarisht raportin me mendime mbi projekt dokumentin e PBA-së për cdo Nj.Q.V.	Deri në 20 Qershor
Dërgon për miratim në K.B, projekt dokumentin e PBA për çdo Nj.Q.V, bashkë me mendimin (raportin) e M.F.	Deri në 30 Qershor
Publikimi i dokumentit të parë të PBA-së të miratuar	Deri në 5 Korrik
Përgatit dhe miraton në K.B, tavanet përfundimtare të shpenzimeve të PBA-së, në nivel programi sipas udhëzimit plotësues të MF.	Deri në 20 Korrik
Kryetari, shpërndan Udhëzimin plotësues të përgatitjes se PBA-së, në Njësitë Shpenzuese.	Deri në 25 korrik
Përgatitet projekti i rishikuar i PBA-së.	Gusht
Publikimi i dokumentit të PBA-së të rishikuar.	Gusht
Organizimi i Seancave Dëgjimore me komunitetin dhe grupet e interesit, ku mbahen proces- verbalet e takimeve së bashku me qendrimet përkatëse të Nj.Q.V që bëhen pjesë dokumentit të projektit të PBA së.	Deri në 31 Gusht
Miraton ne KB, dokumentin e PBA-se te rishikuar.	Shtator
Dërgimi në MF të dokumentit të PBA-së të rishikuar dhe të miratuar në K.B, së bashku me një informacion mbi rekomandimet e dhëna nga MF në fazën e parë.	Deri në 15 Shtator
Përgatit projekt buxhetin vjetor, pas miratimit te PBA-së të rishikuar.	Deri në 30 Shtator
Përgatit projektin e PBA së përfundimtare dhe projekt buxhetin vjetor, duke reflektuar rekomandimet përfundimtare të MF.	Tetor
Paraqet projektin e PBA-së përfundimtare dhe buxhetin vjetor për shqyrtim dhe miratim në K.B të NjQV.	Deri në 30 Nëntor
Miratimi në K B i PBA-së përfundimtare	25 Dhjetor

Publikimi i dokumentit të plotë të PBA-së, përfshirë dokumentacionin shoqëruar të tyre.	Deri në 31 Dhjetor
Dërgon dokumentin e plotë të PBA-së në M.F , 15 ditë pas miratimit në K.B dhe publikimit të PBA-së.	Deri 15 Janar

2. Ngarkohen të gjithë Drejtoritë, Ndërmarrjet dhe Institucionet në varësi të Bashkisë Durrës për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 24.12.2020




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 1103 prot.

Durrës, më 30. 12.2020

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.124 datë 24.12.2020

“Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm (PBA) për vitet 2022-2024 dhe buxhetit vjetor”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

